ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË**

Për: **VET-FKEE2020-24-8758-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Angazhimi i Kompanive për kryerje të punëve ndërtimore për implementimin e masave të Efiçiencës së Energjisë në ndërtesat shumë banesore sociale Mitrovicë, Prizren dhe Lipjan**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

U – UNIQUE SH.P.K. & ASTRAPLAN SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR. HOLGER PETERSEN P.N.,
(Adresa)

Prishtinë **10000**
(Vendi) *(Kodi postar)*

044 / 664 – 220
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

ULPIAN TAHIRI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

uunique.shpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

14.02.2025
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

- 27.08.2024 - Njoftimi për Kontrate, ne E-Prokurim.
- 24.09.2024 –Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve
- 28.10.2024 – Letra standarde për tenderuesin e eleminuar OE: U-UNIQUE SHPK
- 29.10.2024–Kërkesë për qasje në dokumente
- 01.11.2024- Kërkesë për rishqyrtim
- 04.11.2024- Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nga AK-ja
- 14/11/2024- Ankese ne OSHP me nr. 1099/24
- **20.12.2024 – Vendimi OSHP: 2024/1099, aprovohet si e bazuar ankesa dhe lënda kthehet ne ri-vlerësim**
- 30.12.2024- AK-ja Anulon vendimin e mëparshëm dhe kthen lenden ne ri-vlerësim
- 08.01.2025 B47 Letër Standarde për Sqarimin e Tenderit GOE U-Unique SH.P.K & Astra Plan.pdf
- 13.01.2025 Përgjigje ne kërkesën për sqarime
- 04.02.2025- Kërkesë për rishqyrtim
- 05.02.2025- Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nga AK-ja

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja ne mënyrë automatike nga sistemi elektronik e-prukurimi

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Ne kemi dorëzuar kërkesë për rishqyrtim me datën 27.12.2024, kemi kërkuar qe te rishqyrtohet vendimi i AK-s, kërkesa është refuzuar nga AK-ja me 31.12.2024.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

- ***Vendimi I OSHP: 2024/1099***
- **Neni 1 – Qëllimi**
- **Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**
- **Neni 7 – Barazia ne Trajtim / Jo-Diskriminimi**
- **Neni 56 – Dispozitat e Përgjithshëm mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**
- **Neni 59 – Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve**
- **Neni 60 – Kriteret per Dhenien e Kontrates**
- **Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

AK-ja edhe përkundër qe Vendimi i OSHP-s me nr**: 2024/1099** i datës 20.12.2024, ka kthyer lenden ne ri-vlerësim pasi qe i kemi plotësuar kushtet dhe jemi eliminuar padrejtësisht nga komisioni vlerësues, përsëri komisioni na ka diskriminuar duke na eliminuar padrejtësisht dhe ne kundërshtim me vendimin e OSHP-s, LPP-n dhe RRPP-n, saktësisht nenin 40.2.1

citojmë: *(Kurdo që aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim në bazë të një kërkese të OE për rishqyrtim të vendimit të AK-së, AK e kthen lëndën në rivlerësim për të korigjur parregullsitë e mundshme ligjore. Kurdo që aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim në bazë të një vendimi të OSHP-së, **rivlerësimi bëhet për të korigjur parregullsitë e mundshme ligjore sipas vendimit të OSHP-së.** Rivlerësimi i tenderëve mund të bëhet nga i njëjti komision, i cili ka kryer vlerësimin e tenderëve.) mbarim citati.*

Çka do te thotë se te gjitha kushtet dhe kërkesat e DT-s i kemi plotësuar bazuar ne vlerësimin nga komisioni fillestar i AK-s,

Shih arsyetimin e komisionit te pare, pra ka te bej vetëm me paramasën

Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:
ARSYETIM
Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :
- Ju nuk keni respektuar format standarde të ngarkuara në sistemin e E-Prokurimit, konkretisht formatin e paramasës në EXCEL, BOQ është e ngarkuar në formatin PDF.

Dmth edhe pse ne si GOE ne vlerësimin fillestar sipas komisionit i kemi plotësuar te gjitha kushtet përveç "paramasës pdf ne vend te exellit" e qe OSHP-ja e ka vendose me vendimin e lartcekur, dhe konform RRPP nenit 40.2.1 AK-ja është dashtë qe vetëm këtë shkelje te korrigjoj e jo te mundohet qe te na eliminoj duke u munduar qe te kaloj ne pretendime te paqena ne vlerësimin 1.

Nenit 1 – Qellimi

AK këtë ligj nuk e respektoi për faktin se nuk siguroi në mënyrë efikase dhe transparente shfrytezimin e fondeve publike dhe rrjedhimisht e dëmton buxhetin e Republikës se Kosovës për **61,525.49 EURO.**

Gjithashtu anëtarët e komisionit vlerësues shkelën mbi integritetin dhe përgjegjësin e vet si zyrtar publik të përfshirë në këtë aktivitet të prokurimit ku të ndikuar në interesat personale shfaqen diskriminim gjatë vlerësimit të ofertave duke i lënë anash kërkesat procedurale dhe qenësore të këtijë ligji dhe me anë të këtyre shkeljeve është shkelur edhe pika 3 e këtijë neni ku ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Nenit 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Oferta jonë është me çmimin më të ulët për **61,525.49 EURO** pra ashtu siç është përcaktuar në FTD – Kriteri i dhënies – Çmimi më i ulët dhe AK me vendimin e saj nuk arriti të sigurojë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
Me këtë veprim AK-ja nuk e ka për synim efikasitetin dhe ekonomicitetin pasi qe ka rekomanduar dy here radhazi pa asnjë keqardhje për dëmtim buxheti një kompani me te shtrenjtë se ne si GOE ankues për **61,525.49 EURO, dhe atë ne kundërshtim me vendimin e OSHP-s nr: 2024/1099** i datës 20.12.2024.

Nenit 7 – Barazia ne Trajtim / Jo-Diskriminimi

Për ne si GOE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit është e pakuptimt se si AK – FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË po përdorë standarde të dyfishta dhe se nga qasja ne dokumente vërehet qarte se OE i rekomanduar për kontratë është favorizuar hapur nga komisioni vlerësues për arsyet ne vijim:

- Ka bashkangjitur dokumente te një kompanie te 3-te qe nuk është ne konzorcium fare me te, dhe jo te anëtari i grupit P&I shpk me ç' rast Lista e kontratave nuk i plotëson kërkesat e DT-s, kushte administrative qe duhet te eliminohet si i pa përgjegjshëm. Kjo e vërteton se AK-ja ka favorizuar OE te rekomanduar, ndërsa neve si GOE qëllimisht na ka diskriminuar.
- OE te rekomanduar i janë kërkuar 2 here sqarime te njëpasnjëshme për te nxjerre si te përgjegjshëm, (Letër sqaruese 17.10.2024, dhe Letër sqaruese 24.10.2024)
- Neve na është bere kërkesë ne kundërshtim me FDT-n dhe kësi lloj kërkese nuk i është bere asnjë kompanie ne gare.
- Edhe pse ne dokumentin e bashkangjitur (Letër Konfirmim) nga Dajting SHPK për kontratën nga FKEE, nuk është referencë siq është kërkuar, me datën 15.10.2024 ngrit ne vete shume pikëpyetje pasi qe jeni i njëjti institucion dhe rrjedhimisht nuk ka qen e nevojshme qe te verifikohet kontrata e tille, por me shume e keni bërë si alibi për eliminimin tone.
- Ky dokument nuk e ka titullin dhe nuk është Reference (pra as OE i propozuar per dhenie nuk i ka te gjitha kontratat e deshmuara edhe me referenca) dhe ne fjalinë e fundit cekëte se objekti është nen garancinë 1 vjeçare, e qe gjatë diskutimit ne qasjen ne dokumente te tenderit me datën 31.01.2025, AK-jna na i kontestoj pranimet teknike pikërisht për këtë shkak (se janë nen garancinë 1 vjeçare)

Ne si GOE edhe pse ju kemi kthyer përgjigjet e kërkuara e qe kanë qen kërkesa te jashtëligjshme, komisioni vlerësues nuk i kanë marre për baze përgjigjën tone dhe kanë pohuar se projektet e prezantuara nuk i plotësojnë kushtet sipas dosjes se tenderit.

Ne si GOE i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e Dosjes se tenderit dhe Njoftimit për kontrate, citojmë nenin V te U002-2024:

V. **Shënim për evidencën dokumentuese:**

- Në raste kur lëshimi i dokumenteve ose çertifikatave, nën **kërkesat e përshtatshmërisë profesionale** nuk janë të arritshme për arsye objektive, ose kur këto dokumente nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat evidenca duhet të prodhohet, një deklaratë e shkruar në betim nga OE mund të pranohet si evidencë e mjaftueshme. (neni 66 i LPP-së).

E me çka ne ju kemi deklaruar se disa institucione po kanë procedura burokratike për te lëshuar referenca, dhe ne, në ofertën tone i kemi dorëzuar raportet e pranimit, si dhe ne kërkesën për rishqyrtim i kemi bashkangjitur edhe referencat.

DMTH nga krejt kjo qe sqaruam me larte, kjo pabarazi dhe diskriminim gjatë vlerësimit të ofertave u bë me qëllim të shpërblimit me kontratë të një OE të favorizuar për ta dhe eleminimit tonë nga ky aktivitet i prokurimit.

Krahasuar me ofertën tonë që jemi më të lirë për **61,525.49 EURO**, jemi diskriminuar pa asnjë arsye.

Nenit 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

AK dhe komisioni vlerësues përmesë Njoftimit mbi vendim dhe letrës standarde ka bërë shkelje të këtijë neni sepse nuk e respektoi kriterin kryesor për dhënie të kontratës ne kundërshtim me piken 2.1 kritereve të përzgjedhjes të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit në përputhshmëri me paragrafin 2. të nenit 51 të këtij ligji.

Nenit 59 – Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve

Komisioni i vlerësimit pran AK-s nuk ka bere vlerësimin real ne përputhje me nenin 59 dhe me këtë konsiderojmë se është vepruar ne kundërshtim me parimet themelore të përcaktuara me LPP, dhe është shkel neni 40 paragrafi 1 e RRPP-s Nr.001/2022 e plotësuar me RRPP nr. 002/2024. Komisioni Vlerësues është përgjegjës për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e Tenderëve në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP.

Komisioni nuk i ka marre si te mirëqena pranimet teknike, ku nga komisioni i vlerësimit paraprak kanë qenë te pranuara kontrata me këto pranime,
Vlen te theksohet se si AK-ja merr guximin dhe nuk i merr parasysh pranimet teknike nga komisioni prej 3 anëtaresh por, e vlerëson referencën e lëshuar nga një person.
Komisioni i vlerësimit dhe ZPP-ja, nuk kane bere vlerësim ne përputhje me nenin 59, pasi qe OE munde te ofrojnë dokumentet minimale për kualifikim.

Po ashtu paragrafi 4, pika (ii) i nenit 59 te LPP-s thot:
Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. ***Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse:***

(i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose

(ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Nenit 60 – Kriteret per Dhenien e Kontrates

Ky nen nuk u respektua fare edhe për faktin se oferta jonë është oferta me Çmimin më të ulët ashtu siç është përcaktuar në DT – Kriteri i dhënies – Çmimi më i ulët., dhe i kemi plotësuar te gjitha kërkesat minimale sipas DT-s.

Nenit 69 – Aftesia Teknike dhe/ose Profesionale

Në njoftimin mbi vendimin e AK-së-eliminimin tone shihet qartë se arsye e vetme për eliminimin tonë ka qenë mos dorëzimi i Paramasës në formatin excell, kete e ka sqaruar vendimi i
OSHP-se nr: 2024/1099 i datës 20.12.2024, pasi të gjitha kriteret teknike dhe profesionale të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit janë plotësuar nga ana jonë AK-na eliminon pa arsye ku kërkon nga ne referencat edhe pse i kemi dorëzuar ne ofertën tone pranimet teknike.

Me këtë konstatojmë se AK-ja ka shkelur paragrafin 1 te nenit 69 te LPP-s, *citojmë: 1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkese, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen.*

Duke u bazuar edhe ne sqarim qe na kanë kërkuar AK-ja e qe janë ne kundërshtim me nenin 69, ne ju kemi përgjigjur dhe AK-ja konsideron si jo te mjaftueshme, gjithashtu duke u bazuar ne shembullin mbi Udhëzimin nr. 02/2024, ne kuptim të nenit 69 paragrafi 2.1, 4.2 dhe 6.2 shprehja "…..**te realizuara ne tre vitet e shkuar"** nënkupton **Kontratat për punë të realizuara (përfunduara)** duhet te jene te pranuar pranimet teknike nga AK-ja. Po ashtu bazuar ne nenin 10 te Udhëzimin nr. 02/2024 (Dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata) -nënkupton referenca/certifikata e pranimit teknik kanë kuptimin e njëjt.

Lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar Dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata)	Mund të kërkohen informata sqaruese	69

Gjatë qasjes ne dokumente na është thënë verbalisht se jemi eliminuar si pasoje e mungesës se referencave për projekte e paraqitura, ne njoftim B58 nuk është e cekur se mungon referenca. Mirëpo ne kërkesën për ri-shqyrtim, ju kemi bashkangjitur edhe referencat, AK-ja nuk ka marr mundin te korrigjoj vendimin mbi njoftimin B58, te datës 30.01.2025, dhe na e refuzon kundërligjshëm kërkesën për rishqyrtim, me ç'rast mos respektimi i vendimeve të OSHP-së konsiderohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97 te e RRPP-s Nr.001/2022 e plotësuar me RRPP nr. 002/2024, paragrafi **h.**

Përfundim i pretendimit ankimor.

Bazuar ne nenin 105 te LPP-s 2.10. t'i japin urdhër autoritetit kontraktues duke e detyruar autoritetin e tillë që të korrigjojë shkeljen e pretenduar dhe/ose të parandalojë dëmtimin e mëtejmë të parashtruesit të ankesës dhe/ose të ndonjë pale tjetër të interesuar;

I. **APROVOHET si e bazuar ANKESA e GOE: " U – UNIQUE " SH.P.K. & ASTRAPLAN SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit: Sa i përket tenderit për: *Angazhimi i Kompanive për kryerje të punëve ndërtimore për implementimin e masave të Efiçiencës së Energjisë në ndërtesat shumë banesore sociale Mitrovicë, Prizren dhe Lipjan* me nr. Prokurimit *VET-FKEE2020-24-8758-5-1-1*,**
II. **Anulohet njoftimi mbi Vendimin e AK-s FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË të datës 30.01.2025, si dhe ky aktiviteti i Prokurimit: *Angazhimi i Kompanive për kryerje të punëve ndërtimore për implementimin e masave të Efiçiencës së Energjisë në ndërtesat shumë banesore sociale Mitrovicë, Prizren dhe Lipjan* me nr. Prokurimit *VET-FKEE2020-24-8758-5-1-1*, kthehet ne RI-VLERESIM.**

9. Dëmet materiale

Fitim i humbure, humbja e kohës, shpenzimet material ne përgatitjen e ofertës, sepse po te behej vlerësimi real dhe sipas kushteve ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate, Ne do duhej te ishim shpallur fituesit e kësaj oferte nga komisioni vlerësues, pasi qe e plotësojmë kushtin Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulet për **61,525.49 EURO** se sa OE i preferuar i AK-s për tu rekomanduar për kontratë.